

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	ver. 1.1	faqe 1 nga 2
Departamenti i Burimeve Njerëzore		Sektori i Personelit

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenin 4 (paragrafi 1, 2, 3, 4, 5) dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe pikën 4.4, 5.1.1, 6.2 dhe 9.2 të Politikës së Rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës së lirë të punës:

1. Punëtor/e në higjienë (1 kryes)

Kushtet e përgjithshme:

Kohëzgjatja e punësimit: Për kohë të pacaktuar.

Në tekstin në vijim përdorimi i njërës gjini nuk përjashton gjininë tjetër.

Orari i punës: Puna me orar të plotë. Lartësia e pagës do të përcaktohet në harmoni me politikat e aprovuara të KOSTT-it.

Përkrahimi i detyrave të punës për pozitën Punëtor/e në higjienë (1 kryes)

Nr. referues i pozitës: 1.14.5.5

Detyrat e përgjithshme

Punëtori në higjienë është përgjegjës për pastërtinë e të gjitha hapësirave të punës, duke përfshirë edhe inventarin në gjithë ambientin punues.

Detyrat specifike:

- Mirëmbajtja e higjienës në tërë objektin.
- Larja dhe pastrimi i të gjitha pjesëve të objektit si dritaret, dyert, dyshemënë, inventarin e zyrave, etj.
- Mbledhja dhe hudhja e hedhurinave në vendin e pacaktuar.
- Raportimi i prishjeve të ndryshme të cilat janë të ndërlidhura me mirëmbajtjen e higjienës.

Të tjera

Kryen detyra të tjera të cilat kërkohen nga Menaxheri për Menaxhimin e Objekteve dhe të cilat janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it.

Nga punëtori i cili kryen këtë detyrë mund të kërkohet edhe puna me orar të ndryshuar, varësisht nga nevojat e KOSTT.

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera për pozitën Punëtor në higjienë:

Kandidatët/et përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të cilat kërkohen me ligj, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Kualifikimi i ulët-Shkolla fillore
- Besueshmëria

Kushtet e punës: Puna në hapësirat e KOSTT-it

Vendi/Lokacioni: Selia Qendrore e KOSTT-it

Forma e aplikimit për pozitën e shpallur:

Të interesuarit mund të aplikojnë përmes internetit duke i plotësuar aplikacionet të cilat mund t'i shkarkojnë nga Web Faqja e KOSTT-it: www.kostt.com

E-mail adresa ku duhet të aplikohet është: punesimi@kostt.com

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat e parashtruara si në konkursin publik të shpallur në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen zyrtare të KOSTT-it.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e diplomës së shkolimit si dhe kopjet e dëshmive tjera sipas kërkesave të konkursit.

Dokumentet origjinale të cilat i vërtetojnë faktet e theksuara në aplikacion duhet të prezantohen në momentin e intervistimit ose para intervistimit nëse kërkohen.

Selektimi i kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit, testimi me shkrim, intervista, përzgjedhja dhe informimi i kandidatëve do të bëhen në përputhje me afatet dhe kriteret sipas udhëzimit administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nr.07/2017.

Konkursi publik mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e shkruara të informimit dhe në webfaqen e KOSTT, nga data 19.04.2023 deri më 03.05.2023 ora 24:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

KOSTT ofron mundësi të barabarta të punësimit për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe inkurajon kandidatët e gjinisë femërore, të rinjtë dhe pjesëtarët e komuniteteve që të aplikojnë për këto vende pune.